



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për fushën e Statistikave Zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e kryeministrit/Ured Premijera/Office of the Prime Minister

Agjencia e statistikave te Kosovës/Agencija za Statistike Kosova/ Kosovo Agency of Statistics

**KONCEPT DOKUMENT PËR FUSHËN E STATISTIKAVE ZYRTARE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Prishtinë, korrik 2015

Kapitulli 1: Hyrje

Ish - Enti i Statistikës i Kosovës (ish - ESK) ka vepruar si zyre profesionale që nga viti 1948 dhe ka vazhduar punën gjatë të gjitha fazave zhvillimore të Kosovës deri në statusin e saj aktual. Me 2 gusht të vitit 1999, ish-ESK-ja u riformua si institucion i pavarur dhe profesional i administratës publike në Kosovë. Gjer ne mesin e muajit dhjetor 2011 ish-ESK-ja ishte një agjenci ekzekutive, e lidhur me Ministrinë e Administratës Publike (MAP) e cila vepronte sipas një rregulloreje statistikore (Rregullorja administrative e UNMIK-ut 2001/14), e cila kishte hyrë në fuqi më 2 korrik të vitit 2001.

Me Ligjin e ri pësuan ndryshime qenësore si ne përmbajte po ashtu edhe ne mënyrën e organizimit të saj. ish ESK-ja, emërtohet Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si dhe behet transferimi i përgjegjësisë nga MAP-i në Zyrën e kryeministrit respektivisht ASK-ja raporton tek kryeministri i Kosovës e jo tek MAP siç ishte me pare. Ligji ka për qëllim të ofrojë një kornizë ligjore për rregullimin e organizimit dhe prodhimit të statistikave zyrtare në Kosovë.

Ligji vendos hapat e planifikimit, programimit dhe zbatimit të Statistikave Zyrtare. bazuar në këtë ASK-ja ka hartuar Programin e Statistikave Zyrtare (PSZ) i cili përbën edhe kornizën e prodhimit. Një Program pesë vjeçar 2013-2017 është hartuar nga ASK-ja, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Këshillit të Statistikave dhe në konsultime me përdoruesit dhe prodhuesit e statistikave zyrtare. Prodhuesit e statistikave zyrtare janë ASK, Banka Qendrore e Kosovës, dhe Ministria e Financave dhe agjencive të tjera qeveritare të autorizuar nga ASK. PSZ është i orientuar nga Programi Statistikor i Bashkimit Evropian.

Ligji përshkruan, përmbajtjen e programit zyrtar të statistikave (PSZ) kushtet e prodhimit, të mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe shpërndarjes së tyre. Po ashtu shpjegon edhe detyrimet për të përdorur standardet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar si dhe metodat në shkëmbimin e të dhënave.

Prodhimi aktual, kërkesat e përdoruesve vendor, kërkesat nga BE dhe organizatat tjera ndërkombëtare (OKB, FMN, BB, etj.) formojnë themelet e planit pesë-vjeçar respektivisht programit të saj të punës në periudhë afatmesme. Format e reja planifikuese për ASK-në janë prezantuar në Planet Vjetore të Statistikave Zyrtare (PVSZ) për vitin 2013, 2014 dhe 2015 të cilat janë dorëzuar dhe aprovuar në Qeveri, si dhe në proces është hartimi i planit të punës për vitin 2016. Kjo është një dëshmi e një procesi planifikues sipas standardeve ndërkombëtare dhe tregon se si ASK do të zbatojë në përputhje me kërkesat e Ligjit detyrimet për standardet dhe parimet e cilësisë. Në programin vjetor të statistikave zyrtare (PVSZ) është integruar një proces i orientuar planifikimi i të gjitha produkteve statistikore si dhe Korniza e Vlerësimit të Performancës për funksionimin e brendshëm në ASK. Kjo kornizë do të nxjerr raporte të rregullta mbi përparimet dhe zhvillimin e prodhimit si dhe procesin e prodhimit.

Kosova synon integrimet evropiane, prandaj standardet që do të vendosen do të jenë të bazuara në rregulloret e BE-së. Shumë nga këto politika do të kërkojnë statistika zyrtare të besueshme

dhe në kohën e duhur me qëllim të zhvillimit të tyre dhe matjes së progresit drejt arritjes së qëllimeve, që ka caktuar Qeveria.

Statistikat zyrtare, sipas rekomandimeve të Eurostat-it por edhe vete institucioneve të vendit janë çështje/prioritete me qëllim të krijimit të një baze të mirë dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave statistikore dhe përdorimit të tyre si në planin e brendshmen dhe atë ndërkombëtar. Pavarësia profesionale dhe rritja e kapaciteteve janë parakushte për përparimin e mëtejshëm të statistikave zyrtare me qëllim të përmbushjes të gjitha obligimeve që dalin nga procesi i integritimeve evropiane të Kosovës.

Rëndësia e statistikave rritet edhe me shume gjatë procesit të integritimeve evropiane të Kosovës. Në këtë rrafsh në takimin e dytë të Ekipit Negociator të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të mbajtur në Prishtinë, tetor 2013, ndër tri shtyllat kryesore për MSA-në, është theksuar edhe shtylla e të bazuarit në fakte dhe statistika.

Si pasoje e procesit të integritimit duke mos zvogëluar rendësin e përmbushjes së nevojave të brendshme, të dhënat dhe statistikave në vazhdimësi do të jenë shumë të kërkuara dhe të domosdoshme gjatë gjithë procesit të MSA-së, dhe të gjitha proceseve të tjera të Integritimit Evropian të vendit tonë.

Në Vlerësimin e Misionit të Eurostatit të muajit Maj 2013 dhe 2014, Sistemi Statistikor i Kosovës, respektivisht Agjencia e Statistikave të Kosovës, është vlerësuar se ka bërë progres. Në këtë vlerësim janë dhënë edhe rekomandime të rëndësishme dhe të qarta për të ardhmen e Sistemit Statistikor të Kosovës dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Disa nga rekomandimet janë investimi për prodhimin e statistikave ekonomike përmes ngritjes së numrit të kapaciteteve njerëzore si dhe ngritja e cilësisë së të dhënave/publikimeve tjera statistikore me theks të veçantë pavarësisht institucionale dhe profesionale.

Rëndësia e Statistikave Zyrtare është mjaftë e madhe ngase me statistika të publikuara nga ASK-ja dhe institucionet tjera qeveritare ofrohet informacione të ndryshme sasiore dhe cilësore për të gjitha fushat kryesore të jetës së qytetarëve, të tilla si zhvillimi ekonomik dhe social, kushtet e jetesës, shëndetësia, arsimi dhe mjedisi, etj. Statistikat zyrtare dalin nga mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, në informacion statistikor. Më pas ato u shpërndahen përdoruesve për të rritur njohuritë e tyre në lidhje me një temë të veçantë ose zonë gjeografike, për të bërë krahasime mes rajoneve dhe vendeve, për të kuptuar ndryshimet neper kohë (të dhëna në seri kohore). Statistikat zyrtare japin informacione mbi financat, ekonominë dhe zhvillimin social të qashtme për publikun, duke lejuar vlerësimin e ndikimit të politikave të organeve vendimmarrëse dhe duke përmirësuar llogaridhënien.

Duke ditur statusin aktual të zhvillimit të prodhimit të statistikave në ASK është shumë e rëndësishme që të forcohet rëndësia e prodhimit të qëndrueshëm e mbështetur nga një program bazë i përshkruar si niveli minimal i prodhimit të statistikave të prodhuara nga ASK në mënyrë që të mbulojë kërkesat për marrjen e vendimeve nga qeveria. Nevojat e mëtejshme të statistikave të shprehura nga përdoruesit vendor ose ndërkombëtarë, si dhe nga programi

statistikor i BE, do të vendosen si prioritete në programin e zgjeruar (PZSZ) dhe do të plotësohen gjatë periudhës së ardhshme pesëvjeçare.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka detyrë kryesore të përcaktojë nevojat e përdoruesve dhe t'i filtrojë ata për nga rëndësia. Më pastaj, ata transformojnë nevojat përkatëse të përdoruesve në koncepte të matshme për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre. ASK është në krye të koordinimit në mes të prodhuesve statistikor dhe siguron koherencën dhe pajtueshmërinë e sistemit statistikor me standardet e miratuara.

ASK është përgjegjëse për prodhimin e me shume se 40 produkteve statistikore që japin informacione mbi aspektet ekonomike, sociale, popullsisë, bujqësisë, mjedisit, energjisë, etj. Produktet statistikore janë të prodhuara në intervale të ndryshme kohore. Qeveria e Kosovës është në procesin e integritimeve evropiane në planin e jashtëm dhe hartimi i politikave zhvillimore në planin e brendshëm mbi bazën e këtyre proceseve, sigurimi dhe përmirësimi i statistikave zyrtare është mjaft i rëndësishëm çka e bën edhe me të domosdoshëm dhe arsyeshëm ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi statistikën zyrtare.

Gjithashtu ASK është përgjegjëse që metodologjitë statistikore të përdorura në Kosovë të jenë në linjë me ato të përdorura në vendet e tjera në rajon dhe Evropë. Prandaj nga e gjithë kjo që është përshkruar me lartë rëndësia e statistikave që vend mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror të Kosovës. Të gjitha çështjet që duhet plotësuar dhe ndryshuar në Ligjin e Statistikave Zyrtare do të shtrohen në brendi të këtij dokumenti duke reflektuar si nevojë e ndryshimit për përmirësimin e statistikave të Kosovës në përputhshmëri me ato të BE-se.

Në procesin e mëtutjeshëm ASK-ja do të konsultojë dhe ofrojë dokumente shtese mbi nevojën dhe arsyeshmërinë e ngritjes së kapaciteteve dhe përafrimit të tyre me BE-ne, në fushën e statistikave zyrtare gjithashtu vlen të theksohet se fusha e statistikave zyrtare është përfshirë e dhe në planin e veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) fushe e cila nuk ka implikime financiare.

Kapitulli 2:Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Ligji mbi statistikën zyrtare NR. 04/L-036 ka hyrë në fuqi nga mesi i muajit Dhjetor 2011-Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë parimet themelore dhe të krijojë bazën ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës. Mbi bazën e këtij Ligji janë bërë shume përparime si në hartimin e programit 5 vjeçar të statistikave zyrtare, planeve vjetore, raportimet mbi bazën e individuale të çdo të punësuarit përmes sistemit të matjes së kohës prodhuese për çdo produkt statistikor, hartimi i akteve të ndryshme nënligjore, ri-organizimi i ASK-se etj. Efektet apo output e këtyre të arriturave reflektojnë në një kohe me të gjatësi -p.sh. zbatimi i planit strategjik 2013-2017, i cili si objektiv të tij ka efikasitetin e prodhimit dhe uljen e

kohës së prodhimit për të njëjtën sasi të prodhimit statistikor apo nivel me të lartë të prodhimit për kohe e njëjte e prodhimit.

Prandaj për te arritur këto objektiva kërkohen disa ndryshime ne disa segmente te caktuara si:

1. Harmonizimi i parimeve të statistikave zyrtare me ato të Eurostatit gjegjësisht kodin e praktikës evropiane,
2. Fuqizimi i Pavarësisë institucionale dhe profesionale
3. Nënshkrimi i memorandumëve të mirëkuptimit me institucionet vendore
4. ASK-ja i raporton kryeministrit gjegjësisht ZKM-së,

1. 1) Kodi i praktikës te statistikave evropiane te bazohet në 15 parime te cilat kanë të bëjnë me mjedisin institucional, proceset statistikore dhe rezultatet respektivisht output-et. Ky kod ka për qëllim për tu siguruar që statistikatat e prodhuara brenda Sistemit Statistikor Evropian (SSE) nuk janë vetëm të rëndësishme, në kohë dhe të sakta, por edhe në përputhje me parimet e pavarësisë profesionale, paanshmërisë dhe objektivitetit. Një grup i treguesve të praktikës së mirë për secilin nga 15 parimet siguron një referencë për matjen e zbatimit të Kodit te praktikës evropiane. Te gjitha parimet e poshtëshënuara do te përfshihen ne Ligj. Parimet e këtij kodi janë:

1. Pavarësia profesionale,
2. Mandati për mbledhjen e te dhënave,
3. Mjaftueshmeria e resurseve (njerëzore dhe materiale),
4. Sigurimi i cilësisë,
5. Konfidencialiteti Statistikor,
6. Paanësia dhe objektiviteti,
7. Metodologjia baze (shëndoshë),
8. Procedurat e duhura statistikore,
9. Mos ngarkimi i tepruar i respondentëve,
10. Kost efektiviteti (kost benefiti),
11. Rëndësia,
12. Saktësia dhe besueshmëria,
13. afatet kohore dhe përpikëria,
14. Koherenca dhe krahasueshmëria, si dhe
15. qasja dhe qartësia.

Ndërsa sipas Ligjit ekzistues mbi Statistikat zyrtare janë 10 parime, kjo është arsyeja e plotësim ndryshimit te këtij neni.

2. 1) Në muajin Maj 2013, ishte një mision prej zyrtareve te eurostatit ne Kosove respektivisht ne ASK, për të vlerësuar sistemin Statistikor të Kosovës. Një nder rekomandimet/konkluzionet e këtij misioni ishte stabiliteti dhe pavarësia institucionale dhe profesionale e ASK-së.

3. 1) Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) përveç të dhënave primare të cilat i mbledh drejtpërdrejte nga tereni gjegjësisht respondentet në shumicën e rasteve shfrytëzon edhe të dhëna

sekondare apo administrative nga institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës. Nuk janë te rralla rastet kur ASK-ja has ne vështirësi ne sigurimin e te dhënave administrative dhe mu për këtë shkas kërkohet që ligji ekzistues i statistikave zyrtare të harmonizohet dhe në mënyrë që t'i behet e mundur ASK-së, sigurimi si dhe nxitja e institucioneve tjera në nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla me qëllim të sigurimit të dhënave në kohë dhe saktësi. Me fjale të tjera të behet obligative dhënia e të dhënave statistikore nga institucionet tjera për ASK-në.

4. 1) Me ligjin mbi statistikak zyrtare ASK-ja është nën ombrellën e ZKM-së dhe si e tille i raporton kryeministrit të Republikës së Kosovës e jo ndonjë ministrie si me parë.

Sa i përket ndikimit që do të ketë ky ndryshim plotësim Ligj, përmasat ndikuese janë variabile varësisht nga faktorët të cilët determinojnë dhe kërkojnë që sistemi statistikor të jete i qëndrueshëm dhe efikas. Grupet të cilat janë me të ndikuara se sa të tjerat janë natyrisht ato të natyrës shfrytëzuese të të dhënave. Shfrytëzuesit (grupet) me te mëdhenj të dhënave janë: Institucionet e Republikës së Kosovës (e tërë struktura duke filluar nga presidenca deri të nivelet me të ulëta administrative), Institucionet dhe organizata kërkimore shkencore, grupe të biznesit, hulumtues te pavarur etj. Ne këtë kontekst nuk mund te behet ndarja gjeografike lidhur me ndikimin me te madh nga ajo qe u cek me larte ngase te dhënat statistikore shfrytëzohen ne tere hartën gjeografike të Republikës se Kosovës.

Informata

Mungesa e të dhënave statistikore përveç ndikimit negativ në furnizimin me të dhëna statistikore të Institucioneve të Republikës se Kosovës poashtu ndikim negativ do të ketë në procesin e integritimeve evropiane te Kosovës nga dis-harmonia me "Acquis communautaire" si dhe para-dispozitat ne mos-qëndrueshmëri dhe pavarësi profesionale te ASK-se.

Politika aktuale

ASK-ja funksion mbi bazën e Ligjit mbi statistikak zyrtare, ne këtë kontekst ASK-ja ka hartuar planin 5 vjeçar te statistikave zyrtare 2013-2017 dhe mbi bazën e kësaj harton planin vjetor te punës si instrument për te operacionalizuar programin strategjik 2013-2017. Në këtë plan janë të parapara të gjitha hulumtimet statistikore në teren si dhe hulumtime tjera, të cilat burim të të dhënave kanë të dhënat administrative ashtu siç u cek edhe me herët. Në këtë kontekst lidhur me sigurimin e të dhënave administrative duhet nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me IRK si Ministrinë, ATK, KEK Doganat etj. Sipas Ligjit mbi statistikak zyrtare neni 7 pikat 3.1 deri 3.4 shpjegojnë përgjegjësitë e Institucioneve tjera për dhënien e te dhënave statistikore administrative mirëpo ka raste kur institucionet përkatëse veprojnë konform ligjeve apo akteve tjera përkatëse. Ja disa nga përgjegjësitë sipas ligjit te statistikave:

3. Gjatë kryerjes së detyrave ASK-ja ka të drejtë:

3.1. të kërkojë nga njësitë raportuese statistikore të japin të dhëna për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në Program;

3.2. të kërkojë të dhëna administrative dhe statistikore nga ministritë apo nga institucione të tjera;

3.3. të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti tjetër për të përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat, siç parashihen me këtë ligj.

3.4 të dhënat statistikore, të parapara sipas këtij neni, janë të obliguara t'i ofrojnë të gjitha njësitë e institucioneve, përveç nëse parashihet ndryshe me ndonjë akt tjetër ligjor.

Deri me tani është shënuar progres në këtë drejtim mirëpo kërkohet që të këtë funksionalizim dhe institucionalizim i mëtijshëm në këtë rrafsh. (nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare).

Ka pasur raste të neglizhencë në gatishmërinë për të raportuar/ofruar të dhënat nga KEK-u, me përpjekje dhe angazhime të ndryshme është arritur deri tek deblokimi i situatës.

Ligjet dhe aktet nënligjore

LIGJIPËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Nr. 04/L-036

Qëllimi i statistikave zyrtare është mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave për qëllime statistikore për aktivitetet ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Kosovë, si dhe i sigurojnë Kosovës përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Mangësitë tani me janë cekur tek pjesa e mësipërme gjegjësisht tek Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/ problemit kryesor

Aktet nën ligjore;

Rregullore nr. 01/2013 për riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të Punës së agjencisë së statistikave të Kosovës;

Rregullore nr. 11/2013 për implementimin e standardit për klasifikimin e veprimtarive Ekonomike në versionin NACE-rev.2

Udhëzimi administrativ nr. 08/2012 për kushtet dhe mënyrën e ofrimit të të dhënave statistikore të fituara me përpunime të veçanta të statistikave zyrtare;

Udhëzim administrativ nr. 11/2012 për ruajtjen dhe shfrytëzimin e lëndës statistikore;

Programi aktual

ASK-ja është institucion profesional, i pavarur, bartës dhe shpërndarës i statistikave zyrtare dhe koordinator i statistikave zyrtare të Kosovës, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM-ë). ASK, nuk ka ndonjë objektiv dhe program tjetër përveç mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave për qëllime statistikore për aktivitetet ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Kosovë, si dhe i sigurojnë Kosovës përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Ligji mbi statistikat zyrtare definon bartësit e sistemit statistikor të Kosovës si në vijim:

1. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK-ja);
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
3. Ministria kompetente e financave si dhe ;
4. Organet e tjera të autorizuar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të caktuara me Program.

Shpenzimet aktuale

ASK-ja financohet nga Buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës gjithashtu me udhëzim administrativ krijon komisione (të hyra) në bazë të kërkesave për përpunime të veçanta statistikore.

Tabela e shpenzimeve sipas kategorive nëpër vite

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak 2014	Buxheti këtë vit 2015	KASH për vitin e ardhshëm 2016
Paga dhe mëditje	727,956.99	834,829.0	834,829.0
Mallra dhe shërbime	313,661.14	320,450.0	320,450.0
Komunali	19,239.80	31,875.0	31,875.0
Kapitale	0.00	0.0	
Financimi nga donatorët			
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	0.0	0.0	??

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

ASK-ja, ka marrë të gjitha masat lidhur me funksionalizimin e ASK-se dhe organizimin e saj sipas modeleve të vendeve të BE-se me qëllim të realizimit të misionit të saj përmes

përbushjes se nevojave te shfrytëzuesve vendor dhe ndërkombëtar me te dhëna statistikore. Deri me sot, në mase të madhe pothuajse në tërësi ASK-j a, ka zbatuar Rregulloren e Qeverisë për riorganizim e saj duke formuar Departamentin për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim. Krijimi i Departamentit të Regjistrimit dhe Anketave si pjesë e riorganizimit të Zyrave Rajonale. Të gjitha aktivitetet e ndërmarra deri me tani janë si rezultat i zbatimit të Ligjit mbi statistikën zyrtare respektivisht dispozitave të tij. Megjithatë, me qëllim të funksionalizimit të mëtejshëm dhe krijimit të një stabiliteti me afatgjatë Ligji ekzistues ka nevojë për ndryshime dhe plotësime të tij.

Prej riorganizimit, sistemi duhet pres që të përmirësohet efikasiteti i prodhimit dhe në një periudhë afatmesme edhe përmirësimi i cilësisë së statistikave.

Përvoja në shtetet tjera

Natyrisht që vendet e rajonit kanë rregulluar me kohë të gjitha çështjet, që i kanë përafëruar statistikën e tyre me ato të vendeve të BE-së. P.sh, Sllovenia është vend anëtar i BE-se, Zyra statistikore e Sllovenisë, zbaton parimet e kodit të praktikës evropiane. Poashtu zyra e statistikave të Maqedonisë, zbaton parimet e kodit të praktikës evropiane të statistikave, Pra nga përvojat e dy vendeve të rajonit mund të konkludohet se institucionalizimi i pikave të listuar për ndryshim-plotësim të ligjit ekzistues ka bazë mjaft të shëndoshe si nga pikëpamja e vendeve të rajonit, rekomandimeve të Eurostatit por edhe nga vetë nevoja imediate për të krijuar një sistem statistikor të qëndrueshëm efektiv dhe të dobishëm së pari për vete shoqërinë kosovare e gjithashtu edhe plotësimin e obligimeve ndaj proceseve evropiane.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Prodhimi i Statistikave zyrtare dhe Përmirësimi i Sistemit Statistikor të Kosovës në drejtim të përafërimit të tij me Sistemin e Statistikave të Unionit Evropian respektivisht Eurostat-it. Poashtu sigurimi i një stabiliteti afatgjatë dhe pavarësisë profesionale të ASK-se në procesin e prodhimit të të dhënave statistikore dhe përbushjes së misionit të saj në të ardhmen. Efektet do të reflektohen në mirëqeverisjen dhe përbushjen e nevojave të brendshme dhe të jashtme me të dhëna statistikore sipas standardeve ndërkombëtare.

Objektivat

ASK përfaqëson qendrën e sistemit statistikor dhe institucionin qendror të tij. Pra, hierarkia e synimeve të saj gjithashtu rregullon Programin operativ të Statistikave Zyrtare (POSZ), dhe objektivat e POSZ rrjedhin nga programi i statistikave zyrtare (PSZ).

Objektivi specifik i POSZ është përdorimi më i mirë i burimeve të ASK përmes rritjes së efikasitetit të vetë institucionit brenda kuadrit të burimeve ekzistuese. Plotësimi i këtij synimi do t'i mundësojë ASK që të:

- a) Të përmirësoj cilësinë dhe numrin e prodhimeve me burimet njerëzore e buxhetin aktual; b) të përparoj me efikasitet drejt standardeve të BE; c) të rrisë mbështetjen e kapaciteteve kombëtare për ASK; d) të thith fonde shtesë stabile nga donatorët bashkëpunues ndërkombëtar; e) të tërheq më shumë fonde përmes punës me përqindje.

Prandaj për ti arritur këto fusha/objektiva specifike kërkohen te plotësohen disa parakushte si ne vijim dhe pikat te cilat kërkohen te plotësohen dhe ndryshohen përmes këtij koncept dokumenti:

- a) Harmonizimi i parimeve te statistikave zyrtare me ato te eurostatit gjegjësisht kodin e praktikës evropiane;
- b) Zbatimi i Parimit të Kodit të Praktikës Evropiane për pavarësinë profesionale dhe institucionale;
- c) Nënshkrimi i memorandumeve te mirëkuptimit me institucionet vendore dhe institucionet tjera ndërkombëtare;
- d) ASK-ja i raporton kryeministrit gjegjësisht ZKM-se, jo ministrisë si me pare;

Të gjitha pikat e lartcekura janë të **matshme** filluar nga 10 parimet që ekzistojnë në Ligjin ekzistues të cilat duhet harmonizuar me kodin e praktikës evropiane i cili ka gjithsej 15 parime. Në rrjedhën e kësaj nënshkrimi i memorandume çështje e cila matet shumë lehtë ngase kemi të bëjmë me nënshkrimin e memorandumeve me Institucionet e Republikës se Kosovës.

Të gjitha pikat që kemi propozuar për plotësim ndryshim janë të **pranueshme** si nga IRK e poashtu edhe nga Institucionet ndërkombëtare ngase janë në harmoni me Kodin e praktikës evropiane dhe ndikojnë në rritjen e pavarësisë profesionale të ASK-së. Poashtu specifikat e matshme të pranueshme janë edhe **reale** ngase nuk kanë ndonjë ndikim financiar në realizimin e tyre dhe janë të mundshme lehtë të realizohen. Në këtë kontekst te gjitha e elementet e propozuara për ndryshim kanë **një afat kohor** të realizueshëm i cili duhet të aprovohet nga kuvendi i Republikës se Kosovës. Përmes këtij cikli behet e mundur zbatimi i matricës **SMART** lidhur me propozim ndryshimet e ligjit ekzistues të Statistikave Zyrtare.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo(asnjë ndryshim)

Mos ndryshimi i Ligjit do te thotë moszbatim i rekomandimeve te eurostatit dhe te gjeturave nga raporti i progresit për Kosovën. Ndryshimet te cilat tani me i kemi propozuar për ndryshim janë te listuar me sipër. Kjo zbatohet ashtu siç është ne ligj mirëpo ne pretendojmë ta ndryshojmë statusqone dhe ti afrohem praktikës evropiane dhe zbatimit te rekomandimeve te eurostatit.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Ndryshimi i politikës ekzistuese mund të realizohet përmes aprovimit të Ligjit të ndryshuar respektivisht të plotësuar në parlamentin e Kosovës. Ndryshimi i tillë, i Ligjit nuk ka nevojë për shumë personel dhe mjete financiare dhe harmonizim me kodin e praktikës evropiane të statistikave dhe zbatim të rekomandimeve të eurostatit.

Parimet e Kodit të praktikës evropiane, shumica prej tyre janë në Ligjin ekzistues, duhet harmonizuar tërësisht.

1. Pavarësia profesionale,
2. Mandati për mbledhjen e të dhënave,
3. Mjaftueshmëria e resurseve (njerëzore dhe materiale),
4. Sigurimi i cilësisë,
5. Konfidencialiteti Statistikor,
6. Paanësia dhe objektiviteti,
7. Metodologjia baze (shëndoshë),
8. Procedurat e duhura statistikore,
9. Mos ngarkimi i tepëruar i respondentëve,
10. Kost efektiviteti (kost benefiti),
11. Relevanca/Rëndësia,
12. Saktësia dhe besueshmëria,
13. afatet kohore dhe përpikëria,
14. Koherenca dhe krahasueshmëria, si dhe
15. qasja dhe qartësia.

Prandaj opsioni 2 gjegjësisht ndryshimi i politikës ekzistuese për të cilën është edhe pajtohet ASK-ja, vjen si rezultat i pikave të cilat duhet të ndryshohen respektivisht plotësohen në Ligjin ekzistues, si me poshtë:

- ii. Harmonizimi i parimeve të statistikave zyrtare me ato të eurostatit gjegjësisht kodin e praktikës evropiane,
- iii. Zbatimi i Parimit të Kodit të Praktikës Evropiane për pavarësinë profesionale dhe institucionale
- iv. Nënshkrimi i memorandumëve të mirëkuptimit me institucionet vendore dhe institucionet tjera ndërkombëtare në rastet për statistika të veçanta;
- v. ASK-ja i raporton kryeministrit gjegjësisht ZKM-se, jo, Ministrisë;

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Bashkëpunimi ndër-institucional është mjaft i rëndësishëm, në bashkërendimin dhe zbatimin e aktiviteteve si rezultat i ligjeve përkatëse nga Institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës. Me disa Institucione koordinimi është në nivel të kënaqshëm si. psh. me ATK-ne, në Mars 2014 është nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për transmetimin e të dhënave në formë elektronike nga ATK për ASK-ne , në formatin e kërkuar sipas ASK-se. Me institucione tjera janë në proces draftimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit. Ndërsa një ndryshim i qasjes ekzistuese duhet të bëhet me Institutin e Shëndetit Publik Kombëtar (IKSHP), lidhur me

kodifikimin e diagnozave të shkaqeve të vdekjeve nga Instituti i lartpërmendur. Qasja e tillë ekzistuese nga IKPSH është duke shkaktuar vonesa në publikimin e të dhënave në kuadër të statistikave sociale si rezultat i neglizhencave të stafit të IKSHP-se, duke kërkuar pagesa për kodifikimin e diagnozave, kjo nuk është e mundur ngase ASK- nuk e ka të rregulluar me Ligj , këtë çështje.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Gjendja e pandryshuar, jo qëndrueshmëri, etj.	Përafrim me legjislacionin e BE-se dhe qëndrueshmëri të brendshme	Vonesa në publikim të statistikave sociale
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Kosova (mundësisht të specifikohen me shume)	Kosova	ASK- Kosova
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët	Qeveria/ Kuvendi (duhet precizuar sektorët konkret psh, ASK por edhe institucionet tjera që obligohen për zbatimin e politikës përkatëse	Qeveria/ Kuvendi	IKSHP
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	n/a	n/a	n/a
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Ligji i Statistikave zyrtare nr. <u>04/L-036</u>	Ligji i Statistikave zyrtare nr. <u>04/L-036</u>	Ligji i Statistikave zyrtare nr. <u>04/L-036</u>
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat	n/a	n/a	n/a
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	n/a	n/a	n/a
Udhëzimet dhe kodet	n/a	n/a	n/a
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni	n/a (ligji aktual është në fuqi)	TM1/2014	

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Opsioni i pare fare nuk ka nevojë të diskutohet ngase paraqet gjendje statike dhe si i tille ASK-ja nuk e preferon. Opsioni i dyte është opsioni për të cilin jemi përcaktuar dhe kemi determinuar pikat e ndryshimit në këtë dokument.

Përfitimet

1. **përfitimet e opsionit 1 (*status quo*).** Natyrisht që opsioni i pare gjegjësisht gjendja ekzistuese nuk paraqet zbatim të rekomandimeve të eurostatit dhe përafrim me legjislacionin e BE-se. Nga kjo nuk është e vështirë të kuptohet se bene fitet nga opsioni i pare respektivisht nga status qoja janë tejet simbolike. Për-afrimi i legjislacionit të vendeve potenciale dhe kandidat potenciale për në BE është njeri ndër kriteret paraprake. Prandaj në këtë kontest mos ndryshimi ndikon në këtë proces negativisht.
2. **përfitimet e opsionit 2- opsioni i rekomanduar-** 2a) Siç theksuam edhe më lartë përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-se. Parimet e statistikave zyrtare nën 3 - Harmonizimi i parimeve të statistikave zyrtare me ato të eurostatit gjegjësisht kodin e praktikës evropiane, 2b) fuqizimi i pavarësisë profesionale dhe institucionale, paraqet parakusht të qeverisjes me të mire. 2c) Përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit ASK-se i behet e mundur pranimi i të dhënave në kohe dhe formatin të cilin ajo paraqet për të dhëna statistikore administrative. 2d) Raportimi tek Kryeministri apo ZKM paraqet një vije komunikimi me të drejtpërdrejte dhe me efikas në kontekstin e menaxhimit efektiv.
3. **Shëno përfitimet e opsionit 3. n/a**

Siç është cekur më lart me ndryshimin e qasjes ekzistuese nga IKSH, lidhur me kodifikimin me kohe të diagnozave të shkaqeve të vdekjes, ASK-se i behet e mundur marrja me kohe të dhënave si dhe publikimi i tyre në kohe, me këtë rast duke plotësuar komponentin e cilësisë, " publikimi "në kohe" dhe koherent i të dhënave statistikore.

Pasojat negative

1. **pasojat negative të opsionit 1 (*status quo*).** Pasojat nga mos ndryshimi i gjendjes ekzistuese në të ardhmen do të jënë edhe më të mëdha sidomos në procesin e integritimeve evropiane. Disharmonia e Ligjit të Statistikave zyrtare të Kosovës gjegjësisht Mos-harmonizimi i parimeve të Ligjit të statistikave zyrtare të Kosovës me parimet e kodit të praktikës evropiane, Në këtë kontekst ndikimi negativ është i shumë anshëm para se gjithash për vete institucionin e ASK-se, se dyti për të gjitha IRK si dhe hulumtuesit e pavarur dhe organizatat ndërkombëtare.
2. **pasojat negative të opsionit 2 (ndryshimi i politikës ekzistuese).** ASK-ja është përcaktuar për opsionin e dyte duke e cilësuar edhe si rekomandim për institucionet gjegjëse.

Zbatimi i opsionit të dytë do të jetë në proporcion të zhdrejte me pasojat nga mos zbatimi i tij. Me aplikimin gjegjësisht zbatimin e opsionit dy pasojat do të jenë minimale ngase edhe intenca e këtij ndryshimi të Ligjit ekzistues të statistikave zyrtare është që të behet minimizimi i pasojave (efekteve negative) dhe rritja e cilësisë, stabilitetit dhe mirëqeverisjes në ASK.

3. pasojat negative të opsionit 3 (ndryshimi i administrimit ose zbatimit). Pajojë e vetme është vonesa në publikimin e të dhënave statistikore në kohën e duhur. Nëse kodifikimi behet me vonesë atëherë edhe publikimi i tyre do të jetë me vonesë.

Efekti shpërndarës

Sa i përket efektit shpërndarës, hartimi dhe miratimi i këtij koncept dokumenti, do të ketë efekt në përmirësimin e statistikave në nivel të vendit pa dallim rajoni. Prodhimi i statistikave ka efekt pozitiv për të gjithë mirëpo Institucionet e politikë-bërjes dhe vendimmarrëse, Institucionet hulumtuese, shkencore kërkimore etj. përshkallëzohen me efekte me të lartë nga baza e shënimeve që ndërtohet nga ASK-ja .

Kosto

Ndryshimet e propozuara me këtë koncept dokument ashtu siç është theksuar edhe me lartë nuk kanë asnjë ndikim financiar (0.00, EUR.) .Konsultimet do të bëhen edhe me MF, duke plotësuar deklaratën e ndikimit financiar.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4

Kapitulli 7: Konsultimi

Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë, në universitete ose agjenci)

ASK-ja lidhur me kërkesat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistika zyrtare ka zhvilluar konsulta me eksperte të jashtëm respektivisht të eurostatit si znj, Claudia Junker, udhëheqëse e njësisë për bashkëpunim ndërkombëtar në Eurostat Unit A6: si dhe z, Marius Andersen, zyrtar

ndihmës i ekipit për zgjerim ne Eurostat unit A6.Këshillat tashme janë sipërshënuar si pjese e dokumentit.

Konsultimi me ministritë e tjera

ASK-ja, ka shfrytëzuar mekanizmat ne dispozicion për konsultime me palët tjera të interesit. Mekanizmi i cili ne përbërjen e vet ka shumicën e ministrive te Qeverise se Republike se Kosovës është këshilli statistikor. Ne këtë këshill janë te përfshira:

- 1.1.Ministrisë kompetente të Financave;
- 1.2.Ministrisë kompetente të Tregtisë dhe të Industrisë;
- 1.3.Ministrisë kompetente të Arsimit;
- 1.4.Ministrisë kompetente të Shëndetësisë;
- 1.5.Zyrës për Planifikim Strategjik;
- 1.6.Bankës Qendrore të Kosovës;
- 1.7.Administratës Tatimore;
- 1.8.Ministrisë kompetente të Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 1.9.Ministrisë kompetente të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.10. Universiteti, ekspert i njohur për hulumtime në fushën e statistikave; dhe
- 1.11.shoqërisë civile, që përfaqëson organizatat e qendrave kërkimore, dhe
- 1.12.Komunitetit të Biznesit.

Gjithashtu ne baze te rregullores se punës se Qeverise nr. 09/2011, neni 7, ASK-ja ka dërguar koncept dokumentin për konsultim edhe tek palët tjera te interesit për marrjen e komenteve te ndryshme . Përveç zyrës se Sekretarit koordinues te Qeverise se Republikës se Kosovës, qe kane dhëne komente dhe i kemi përfshirë dhe plotësuar ne dokument, tjetër institucion nuk ka dërguar komente lidhur me koncept dokumentin për ndryshimin e ligjit ekzistues te statistikave zyrtare.

Te gjithë përfaqësuesit e institucioneve te lartcekura kane shprehur qëndrimin e tyre ne favor te zbatimit te rekomandimeve te eurostatit, rekomandime te cilat përforcojnë sistemin statistikor te Kosovës dhe përafrimin e tij me Sistemin Statistikor te BE-se.

Konsultimi me akterët - organizatat ose individët që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë

ASK-ja përfitoi nga studimet e fundit vlerësuese të kryera nga përfaqësuesit e BE,FMN, UNICEF, Sida/DFID dhe të tjerë. Të gjeturat dhe rekomandimet kanë të bëjnë me vetë ASK-ne, gjegjësisht organizimin dhe funksionalitetin e saj si dhe me të arriturat e shpejta për sa i përket prodhimit dhe cilësisë së të dhënave, dhe bashkëpunimin brenda sistemit global të të dhënave.

Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile

Agjencia Kontaktimet me përdoruesit janë thelbësore për përmirësimet cilësore dhe për zhvillimin e përmbajtjes së të dhënave. Është hartuar një plan institucional për takime të rregullta me përdoruesit kryesor, nacional dhe ndërkombëtar. Shkëmbimi i përvojës në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe bashkëpunim janë çështje të rëndësishme që duhet të jenë në agjendë. Të merret për bazë praktika e takimeve të rregullta vjetore me donatorët nga ana e ASK-së.

Kapitulli 8: Krahasoni i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opsion)

1. Opsioni i parë nënkupton gjendjen e ekzistuese. Gjendja ekzistuese nuk është e shëndoshë as për vetë ASK-ne as për IRK por as për vetë shoqërinë në tërësi ngase nga gjendja e tanishme pasojat janë me të mëdha se sa përfitimet. Nuk ka harmonizim apo përafrim të legjislacionit, nuk do të ketë pavarësi profesionale, nuk do të ketë efikasitet në shkëmbimin e të dhënave administrative nga institucionet gjegjëse për ASK-ne etj. Efekti financiar siç cekem edhe më lartë nuk do të shfaqet në këto ndryshime.
2. Opsioni i dytë paraqet gjendjen të cilën ne kemi propozuar për ndryshim dhe është opsioni i rekomanduar nga ASK-ja. Përderisa tek gjendja ekzistuese (opsioni i parë) nuk reflektonte asgjë si përfituese tek opsioni i dytë kemi efekte po përfitimet pozitive si: harmonizim apo përafrim të legjislacionit me atë të BE-së, pavarësi profesionale dhe institucionale, efikasitet në shkëmbimin e të dhënave administrative nga institucionet gjegjëse për ASK-ne etj. Efekti financiar siç cekem edhe më lartë nuk do të shfaqet në këtë do ndryshime.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandohet miratimi i opsionit të dytë. ASK-ja, do të bëjë plotësim ndryshimin e Ligjit ekzistues për statistika zyrtare deri në pjesën e parë të vitit, 2015. Ky draft koncept dokument nuk ka implikime financiare gjithashtu nuk paraqet implikime financiare as ndryshimi dhe zbatimi i ligjit me ndryshime mbi statistikën zyrtare. ASK planifikon të përgatisë plotësim/ndryshimet në bazë të konceptit dokumentit të miratuar dhe të dorëzojë projekt Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit brenda TM2/2015, për aprovim në Qeveri

Me miratimin e kësaj politike do të behët:

- i. Harmonizimi i parimeve të statistikave zyrtare me ato të eurostatit gjegjësisht kodin e praktikës evropiane,
- ii. Zbatimi i Parimit të Kodit të Praktikës Evropiane për pavarësinë profesionale dhe institucionale

iii. Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me institucionet vendore dhe institucionet tjera ndërkombëtare në rastet për statistika të veçanta”);

iv. ASK-ja i raporton kryeministrit gjegjësisht ZKM-se, jo ministrisë

1. Zbatuese e kësaj politike është:
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) .

Koha me përshtatshme për aprovimin e këtyre ndryshimeve apo këtij koncept dokumenti do të ishte TM 2/2015

2. Kemi cekur edhe me herët se aprovimi i këtij koncept Dokumenti nuk ka implikime financiare pra buxheti për ndryshime 0.0 euro. Megjithatë do të behet edhe vlerësimi i ndikimit financiar.

Kapitulli 10: Komunikimi

Komunikimi publik përmes faqes zyrtare të Qeverisë dhe ASK-se, me palët e interesit si brenda dhe jashtë Kosovës do të ndikonte pozitivisht në rritjen e imazhit të ASK-se dhe rritjes së konsolidimit të të mëtutjeshëm të ASK-se si Institucion i pavarur, profesional në fushën e kërkimeve dhe publikimeve statistikore. Komunikimi do të behet gjatë fazave të ndryshme:

- a) Në fillim të fazës së hartimit të dokumentit
- b) gjatë fazës së hartimit të dokumentit (me publikun, shoqërinë civile, etj) si dhe
- c) në fazën, pasi të jetë hartuar dokumenti për detyrat dhe obligimet e tij si rezultat i fuqizimit të këtij dokumenti).